



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 03.05.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i Raportit “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018” përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:30 dhe mbaroi në orën 14:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Alban Toro.**

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.**
- 5. Marjana Papa, OSCE.**
- 6. Ervin Karamuço, ISP**
- 7. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 8. Alketa Vushaj, KSHH.**
- 9. Gregor Borgowski, EURALIUS.**
- 10. Klodian Rado, EURALIUS.**
- 11. Valbona Bala (Pajo), USAID.**
- 12. Artan Spahiu, Kryetar i Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr.115/2016.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i Raportit “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018” përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 03.05.2019. Janë të gjithë anëtarët të pranishëm në këtë mbledhje, përveç zotit Alban Toro, i cili për arsye personale nuk është i pranishëm në këtë mbledhje.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës që ju kemi shpërndarë, sot objekt shqyrtimi të kësaj mbledhjeje janë 2 çështje. Së pari është: Shqyrtimi i Raportit “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2018”, i

përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe, së dyti është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata”, dhe ky akt është i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Tani, në lidhje me çështjen e parë dëshiroj t’ju sqaroj se, sikurse jeni në dijeni, bazuar në nenin 82 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ku përcaktohet se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, jo më pak se një herë në vit”, me urdhrin nr. 129, datë 01.04.2019 të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, u ngrit grupi i punës për hartimin e këtij projekt-raporti.

Projekt-raporti, përveç përshkrimit të aktivitetit gjatë vitit 2018 mbi veprimtarinë e kryer nga ish-KLD, mbulon edhe periudhën e aktivitetit të KLGJ deri në muajin prill 2019 duke mbajtur në konsideratë që krijimi i KLGJ erdhi në një situatë vonese, me disa probleme të trashëguara kryesisht nga periudha tranzitore e funksionimit të KLD por edhe me pasoja që sistemi ka në kuadër të proceseve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, u mendua të ofrohej një pasqyrë e punës së muajve të parë të krijimit të KLGJ dhe një pasqyrë faktike mbi situatën dhe funksionimin e sistemit gjyqësor sipas të dhënave të raportuara nga vetë gjykatat.

Ky projekt-raport përbëhet nga 5 kapituj (përfshirë kapitullin e fundit “Konkluzione dhe rekomandime”):

Në kapitullin e parë, “Hyrja”, pasqyrohet kuadri ligjor mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe pritshmëritë e tij.

Në kapitullin e dytë, sqarohet raportimi mbi veprimtarinë e KLD-së, ku jepet një panoramë e zgjeruar mbi veprimtarinë e ish-Inspektoratit të KLD-së, vlerësimet e veprimtarisë profesionale dhe etike të gjyqtarëve, të kryera gjatë vitit 2018, vlerësimin profesional në kuadër të rivlerësimit kalimtar, transferimet dhe pezullimet e gjyqtarëve dhe kërkesat për delegime.

Në kapitullin e tretë, “Raportim mbi veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor”, pasqyrohet në mënyrë të detajuar e gjithë veprimtaria e këtij institucioni, që nga momenti i krijimit deri më tani. Kështu, analizohet veprimtaria e institucionit përmes zhvillimit të

mbledhjeve plenare, veprimtarisë së komisioneve të përhershme të ngritura bazuar në ligjin “Për organet e qeverisjes” dhe veprimtarisë së komisioneve të përkohshme.

Në kapitullin e katërt, pasqyrohet “Analiza mbi situatën e gjykatave në shkallë vendi”. Në këtë kapitull zhvillohet një analizë e bazuar mbi të dhënat statistikore të dërguara nga gjykatat, mbi ngarkesën e gjykatave, shpejtësinë e trajtimit të çështjeve, përdorimin e sistemit audio, vonesat në dorëzimin e vendimeve, etj. Treguesit e performancës që kemi përdorur për të analizuar gjendjen e sistemit gjyqësor në Shqipëri i referohen treguesve të CEPEJ. Gjithashtu në këtë kapitull i dedikohet një pjesë e veçantë situatës në Gjykatën e Lartë dhe përshkruhet veprimtaria e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor si dhe gjendja e burimeve njerëzore në gjykata.

Për të kaluar në mënyrë të detajuar, unë do doja që të ndalesha tek situata që kemi analizuar në këtë projekt-raport.

Sikurse jeni në dijeni, me ndryshimet kushtetuese, është parashikuar se Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të ushtronte veprimtarinë e tij tranzitore deri në datën e ngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ky i fundit duhej të ngrihej brenda datës 12 prill 2017. Në kushtet kur situata faktike u zgjat përtej parashikimeve ligjore, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë vijoi të ushtronte veprimtarinë e tij për rreth 19 muaj më shumë deri në ditën e mbledhjes së parë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që daton më datë 20 dhjetor 2018.

Mos krijimi i KLGJ brenda afateve të përcaktuara krijoi problematikë në funksionimin e sistemit të drejtësisë në tërësi; në garantimin e të drejtave statutore të gjyqtarëve; në mirë administrimin e gjykatave dhe për pasojë dhe në shërbimin ndaj qytetarëve. Kompetencat e paplota të ish-KLD-së nuk garantonin pavarësi, përgjegjshmëri dhe eficiencën e duhur për sistemin gjyqësor.

Në lidhje me statusin e gjyqtarëve, për një kohë të gjatë, u krijua pasiguri dhe paqartësi: në procesin e emërimit të magjistratëve të rinj; në dhënien e lejeve për ushtrimin e veprimtarive akademike apo të lejeve të tjera; në garantimin e një procesi të rregullt ligjor në funksion të procedimit disiplinor për shkak të shfuqizimit të listës së shkeljeve disiplinore nga Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr. 34, datë 10.04.2017; në mos vijueshmërinë e procesit të vlerësimit profesional të gjyqtarëve por duke u fokusuar vetëm në procesin e rivlerësimit kalimtar të tyre.

Këshilli Lartë Gjyqësor, që në fillimet e veprimtarisë së tij u përball me problematika të mbartura të cilat u desh të trajtohen me urgjencë që pas zhvillimit të mbledhjes së parë:

Vakumi që u krijua në drejtimin e disa gjykatave si pasojë e shkarkimit të kryetarëve të tyre gjatë procesit të rivlerësimit. Në këtë drejtim, KLGJ i hapi rrugën zgjedhjes së zëvendëskryetarëve të gjykatave duke miratuar rregulloren përkatëse. Zgjedhja e zëvendëskryetarëve plotëson vakumin që krijohet në rast të mungesës së kryetarit, pasi ligji parashikon që në mungesë të kryetarit, ushtron detyrat zëvendëskryetari. Aktualisht janë zgjedhur 36 zëvendëskryetarë gjykate nga 37 gjykata të nivelit të parë dhe të dytë; Ngritja e strukturës përgjegjëse për bashkëpunimin e nevojshëm me institucionet e rivlerësimit kalimtar për të evituar pengimin e procesit; Trajtimi i një stoku me kërkesa të gjetura, të ardhura nga gjykatat ku kërkohej delegimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të caktuara.

Deri tani KLGJ ka trajtuar 327 kërkesa dhe janë caktuar 427 gjyqtarë; Nisja e procesit të caktimit i përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; Nisja e procesit të emërimit dhe caktimit në detyrë i magjistratëve të cilët përfunduan Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018; Vlerësimi i situatës dhe ngritja e një Komisioni të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë; Ngritja e komisioneve të përhershme sipas parashikimeve ligjore, ashtu edhe komisioneve të posaçme si një domosdoshmëri për të shqyrtuar çështje të veçanta; Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për caktimin e përkohshëm në detyrë të emëruarve të rinj në pozicione të komanduara, rregullat për ngritjen në detyrë në nivele më të larta ose të specializuara të gjyqtarëve, rregullat për procesin e emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, etj.

Pjesë e këtij raporti është edhe një analizë e parë e aktivitetit të sistemit gjyqësor për vitin 2018.

Pavarësisht mungesës së të dhënave të plota dhe mjeteve për një analizë të thelluar të korrelacionit mes të dhënave dhe treguesve, kjo analizë synon të ofrojë një

panoramë të përgjithshme të gjendjes së sistemit gjyqësor në fillim të vitit 2019, gjendjes dhe ecurisë së evadimit të çështjeve.

Kush është metodologjia që kemi përdorur për këtë analizë.

Metodologjia e ndjekur në përgatitjen e kësaj analize është bazuar në sintezën e të dhënave statistikore të dërguara nga vetë gjykatat, sipas një modeli të strukturuar numerik dhe në vijim të kërkesës së Këshillit për informacion, mbi numrin e gjyqtarëve efektivë, numrin e çështjeve të regjistruara në vitin 2018, numrin e çështjeve të mbartura nga viti 2017, numrin e çështjeve të përfunduara në 2018-ën, treguesin e kohës së nevojshme për përfundimin e çështjeve (në ditë), raportin e qarkullimit të çështjeve, koeficientin e shpejtësisë së gjykimit (në %) dhe në numrin e çështjeve të mbartura nga 2018 në vitin 2019. Metodologjia statistikore e përdorur bazohet në indikatorët e performancës të parashikuara nga CEPEJ.

Rritja e backlog-ut.

Në analizë evidentohet ngarkesa në të gjithë gjykatat e vendit ku mund të theksohet që gjatë vitit 2018 janë regjistruar 147,423 çështje. Në mbyllje të vitit 2018 ende ishin pa trajtuar 75,803 çështje në shkallë vendi (ku 28,863 i përkasin vetëm Gjykatës së Lartë) çka vërehet një rritje në krahasim me 1 vit më parë kur flitej për 68,982 çështje të prapambetura. Kjo diferencë pasqyron një përkeqësim të gjendjes sepse është rritur backlog-u në shkallë vendi, rrjedhimisht edhe koha e nevojshme për trajtimin e çështjeve. Sigurisht, si çdo qasje statistikore kjo shifër nuk mund të merret në konsideratë të sqarojë apo të hulumtojë mbi arsyet. Për këto të fundit duhet një analizë cilësore për të mbështetur këto të dhëna sasiore duke vlerësuar korrelacionin përkatës, si dhe duke shqyrtuar nëse mund të merren masa që të eliminojnë apo kufizojnë impaktin e faktorëve ndikues.

Cilat janë gjykatat me ngarkesën më të madhe në numër çështjesh.

Nga të dhënat konstatohet që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ajo Vlorë dhe Shkodër, për sa i përket gjykatave të shkallës së parë, kanë fluksin më të madh të çështjeve.

Nga gjykatat e apelit fluksin kryesor të regjistrimit të çështjeve e ka Gjykata e Apelit Tiranë dhe ajo Vlorë.

Ndërsa për sa i përket gjykatave administrative, vihet re që numri më i madh i çështjeve është reregjistruar sërish në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe atë të Apelit Administrativ.

Duam të sqarojmë që lidhur me vlerësimet që kemi bërë, janë përdorur dy indikatorë që përdor sot CEPEJ: I pari është “Treguesi i ritmit të zgjidhjes së çështjeve” dhe së dyti është “Koha e nevojshme për likuidimin e çështjeve”.

Ajo që bie në sy nga të dhënat mbi këto dy indikatorët e mësipërm është disbalanca në shkallë vendi mes gjykatave. Nga grafikët që janë pjesë e këtij raporti rezulton dhe shihet qartë që ka vend për përmirësim të ndjeshëm në një numër gjykatash. Për shembull: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë deklaroi që ka një tregues për shpejtësinë e gjykimit të çështjes 21% për çështjet penale dhe 58% për ato civile, ndërkohë që të gjithë gjykatat e tjera i kanë këto vlera të paktën mbi 70%, pavarësisht nivelit dhe llojit të çështjeve. Gjithashtu këto tregues paraqesin një variancë më të madhe dhe ndryshon shumë në varësi të nivelit të gjykatës dhe të llojit të çështjes. Vlen të përmendet që koha me e madhe e likuidimit të çështjeve i nevojitet Apelit Administrativ, që rezulton me 803 ditë.

Lidhur me përdorimin e sistemit audio.

Për sa i përket përdorimit të sistemit audio në gjykata për vitin 2018, rezulton se Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka një përdorim 100% të regjistrimit të seanca gjyqësore, dhe me përdorim të kënaqshëm janë të gjitha gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm në nivel apeli. Ndërkohë që Gjykata Administrative e Apelit ka një përdorim të sistemit në nivelin 42%.

Në gjykatat e shkallës së parë konstatohet se përdorim të kënaqshëm ka Gjykata Gjirokastrë, Dibër, Korçë, Kukës, Pogradec, Pukë, Sarandë, Lezhë, Përmet, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Ndërkohë që gjykatat administrative të shkallës së parë Durrës, Gjirokastrë dhe Shkodër, ashtu si dhe gjykatat e rretheve gjyqësore, Durrës, Kurbin, Shkodër, kanë një përdorim nën mesataren e përgjithshme të sistemit për vitin 2018. Një analizë e thelluar për të evidentuar arsyet e mospërdorimit të këtij sistemi, dhe alternativa të përmirësimit të këtij treguesi, është shumë e nevojshme.

Mos shpallja e vendimeve brenda afateve të arsyeshme referuar kuadrin ligjor.

Në lidhje me arsyetimin në kohë të vendimeve gjyqësore, analiza bazohet në mekanizmin e raportimit periodik të kryetarëve, lidhur me respektimin e afatit të dorëzimit në kohë të vendimeve në sekretarinë gjyqësore.

Nga të dhënat e raportuara, për rastet e vonuara të arsyetimit të vendimeve, për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, konstatohet se për vitin 2018, kemi të raportuara nga kryetarët e gjykatave gjithsej 671 raste, nga të cilat, 305 në gjykatat e nivelit të parë dhe 366 raste në nivel apeli me juridiksion të përgjithshëm dhe ku evidentohet se gjykata me numrin më të madh të arsyetimit me vonesë është Gjykata e Apelit Vlorë, për të vijuar më pas me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, dhe më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndërkohë në gjykatat administrative konstatohet në total 547 raste të arsyetimit me vonesë të vendimeve gjyqësore. Me numrin më të madh në këto gjykata shfaqet Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me 407 raste vonesash, pasuar më pas nga Gjykata Administrative e Apelit me 106 raste.

Në përfundim, raporti thekson se KLGJ është e vetëdijshme për mandatin e gjerë qeverisës mbi sistemin gjyqësor Shqiptar, e ndërgjegjshme për problematikat e së shkuarës dhe sfidat e së ardhmes, angazhohet gjatë viti 2019 për të përmbushur një sërë detyrash, si më poshtë:

Miratimin e të gjitha akteve nënligjore të nevojshme për funksionalizimin e vetë KLGJ-së dhe adresimin e nevojave imediate për përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë të gjykatave;

Bashkëpunimin me organet e rivlerësimit kalimtar për të shpejtuar zgjidhjen përfundimtare të ankimeve, duke ulur kështu impaktin e këtij procesi në lidhje me vendet vakante në gjykata dhe efektet financiare që i krijohen buxhetit të shtetit nga pezullimet nga detyra;

Vijimin e procesit të vlerësimit të gjyqtarëve për periudhën 2010-2012 i cili ka mbetur i papërfunduar;

Përfundimin e analizës për rikonfigurimin e hartës gjyqësore, duke mbajtur në konsideratë se ky është një proces i kushtueshëm, i shtrirë në kohë dhe që mund të

kërkojë edhe masa të përkohshme si shkrirja e disa gjykatave me disa të tjera, krijimi i degëve të gjykatave të përkohshme, transferimi i gjyqtarëve nga një degë në një tjetër, standardet Evropiane që aspirojmë për raportin gjyqtar/popullsi.

Nisja e një analize tërësore për problemet e sistemit dhe hartimi i masave afatmesme që mund të sjellin përmirësimin e efikasitetit të gjykatave;

Përfundimin e emërimit dhe caktimit në detyrë të magistratëve që kanë përfunduar studimet në vitin 2018, si dhe mbështetjen e Shkollës së Magistraturës për ngritjen e kapaciteteve dhe mundësisht rritjen e kuotave për t'iu përgjigjur nevojave të sistemit sidomos pas efekteve të reformës;

Hartimin e rregullores së brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor duke saktësuar edhe funksionimin e komisioneve të përhershme;

Zgjedhjen e Këshilltarit të Etikës për hartimin e rregullave të etikës;

Përfundimin e rregullave dhe hapjen e procesit të emërimit për anëtarët e Gjykatës së Lartë;

Bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për të mundësuar ngritjen e Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duke emëruar me prioritet gjyqtarët të cilët konfirmohen në detyrë më pas nga vetingu;

Mbështetjen e Këshillave të Gjykatave si organe të mirë administrimit për çdo gjykatë;

Bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë për kalimin e kompetencave në lidhje me administrimin e gjykatave dhe sistemet e teknologjisë së informacionit;

Krijimin e portalit elektronik të Këshillit të Lartë Gjyqësor i cili krijon lidhjen me faqen e internetit të çdo gjykate me qëllim rritjen e transparencës dhe aksesin e publikut në gjykata;

Kërkesat që ne propozojmë që t'i parashtrijmë Kuvendit, janë që Këshilli i Lartë Gjyqësor kërkon mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me:

Rishikimin e kuadrit ligjor dhe plotësimin e vakumit të krijuar për shkak të shfuqizimit të disa dispozitave nga Gjykata Kushtetuese, konkretisht në ligjin 115/2016 dhe ligjin 96/2016, si dhe ndryshimet e nevojshme që mund të lindin gjatë zbatimit të tyre në praktikë.

Rritjen e burimeve njerëzore në gjykata me të paktën 150 punonjës për administratën gjyqësore në shkallë vendi kur nevojat e raportuara vlerësohen, të paktën duhet të kishim 330 punonjës.

Mbështetjen financiare në investime për rikonstrukcionin apo ndërtimin e gjykatave, si dhe të sistemeve të teknologjisë së informacionit, veçanërisht të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore.

Kjo është në mënyrë të përmbledhur projekt-raporti që Grupi i Punës ka hartuar.

Unë do ju ftoja, nëse keni sugjerime apo komente lidhur me projekt-raportin.

Po!

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Kisha vetëm një saktësim për të bërë, se e dëgjova edhe fjala juaj dhe e konstatova edhe në projekt-raport. Kur flitet që janë ‘deleguar 427 gjyqtarë’, në fakt duhet të saktësohet dhe të thuhet që janë bërë ‘427 delegime gjyqtarësh’ sepse krijohet ideja sikur sistemi ka më shumë se 427 gjyqtarë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Ndonjë koment tjetër?

Dritan Hallunaj: Po, atëherë, thjesht për saktësim, meqenëse edhe zoti Muharremaj e cilësoi këtë. Unë doja të thoja që, në raport përshkruhet që janë dorëzuar rreth 41 raporte mbi vlerësimin profesional të gjyqtarëve, por realisht janë 45. Pra, e përditësuar këto janë shifrat e sotme.

Naureda Llagami: Atëherë, thjesht për sqarim që, raporti ka pasur parasysh deri datën 30 prill. Nëse ne këto i kemi çuar brenda datës 30 prill, okej. Nëse jo, do jetë pjesë e raportimit vitin tjetër. Kështu që, prandaj e kisha merak. Nëse është me datën e 30 prillit, okej, pa diskutim e reflektojmë. Ndryshe, do jetë pjesë e raportit vitin tjetër.

Dritan Hallunaj: Jo, atëherë, konstatimi është thjesht për datën e sotme, janë dy të fundit, por duhet të jetë diku 43.

Naureda Llagami: Jo, nuk e fusim dot në raportim. Është deri në 30 prill.

43, ë?!

Brunilda Kadi: Mos është lapsus kjo tek ‘mos shpallja e vendimeve brenda afateve’, se e tha edhe Brikena. Mos është ‘mos arsyetimi i vendimeve brenda afateve’? Mos është lapsus këtu?

Brikena Ukperaj: Edhe diçka tjetër, se neni 399/2 në fakt nuk ka lidhje me arsyetimin, ka lidhje me kohën gjatë së cilës duhet të përfundojë shqyrtimin e çështjes dhe nuk referon domethënë përmbajtja me këtë. Duhet hequr edhe 399/2, duhet hequr si bazë ligjore.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, tek pika 6 e “Konkluzioneve”, duhet saktësuar që bëhet fjalë për Gjykatën e Lartë, po kështu duhet të reflektohet edhe fakti që akti rregullator për verifikimin e pasurisë dhe figurës... për verifikimin e figurës për kandidatët është përfunduar si draft, i është shpërndarë anëtarëve dhe është në kuadër të procesit të miratimit.

Ka nisur procesi thuhet aty, në fakt procesi i draftimit ka përfunduar dhe jemi në procesin e miratimit. Drafti është përfunduar brenda muajit prill. Qëlluan ato ditë pushimi dhe unë e kam shpërndarë më datë 2 (sa ishte). Por drafti ka përfunduar.

Naureda Llagami: A mund ta themi që Komisioni ka përfunduar draftin?

(Anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat. Hidhet në votim projekt-raporti për miratim.)

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi raportin së bashku me komentet e bëra nga anëtarët.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 03.05.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:30 dhe mbaroi në orën 14:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Alban Toro**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.**
- 5. Marjana Papa, OSCE.**
- 6. Ervin Karamuço, ISP**
- 7. Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 8. Alketa Vushaj, KSHH.**
- 9. Gregor Borgowski, EURALIUS.**
- 10. Klodian Rado, EURALIUS.**
- 11. Valbona Bala (Pajo), USAID.**
- 12. Artan Spahiu, Kryetar i Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr.115/2016.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës.

Atëherë, lidhur me çështjen e dytë të rendit të ditës, prapë Komisioni relatues, do jetë Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Diskutimi për çështjen e dytë ka të bëjë me shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata.

Siç jeni vënë në dijeni buxheti i shtetit për vitin 2019, i miratuar me ligjin nr. 99, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019” ka parashikuar një shtesë prej 20 punonjësish

në numrin e përgjithshëm të punonjësve të sistemit gjyqësor. Kjo shtesë, ka ardhur si pasojë e kërkesës që Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (ZABGJ), bazuar në një analizë të plotë të nevojave për punonjës shtesë në administratën gjyqësore, për efekt të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” si dhe kërkesave të gjykatave të paraqitura në vijimësi, ka prezantuar në fazën e hartimit të projektbuxhetit për këtë vit. Ndërkohë që kërkesa e ZABGJ ka qenë për 83 punonjës shtesë, shtimi i miratuar ka qenë vetëm për 20 punonjës, i cili vlerësohet se është i pamjaftueshëm për të plotësuar nevojat që gjykatat kanë për punonjës të administratës gjyqësore.

Ligji nr.115/2016, në nenin 90 të tij, parashikon se përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata është vetë Këshilli i Lartë Gjyqësor ndaj dhe i takon Këshillit që të bëjë shpërndarjen e këtyre punonjësve nëpër gjykata sigurisht, duke mbajtur në konsideratë, nevojat që ka administrata e gjykatave për punonjës, dhe duke vlerësuar që roli dhe funksionimi i saj përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të sistemit gjyqësor, dhe i shërben mirë administrimit të gjykatave.

Në kushtet kur kërkesat e gjykatave dhe nevojat e tyre janë të ndryshme, për detajimin e 20 punonjësve shtesë, nga ana e Komisionit propozohet që ky numër punonjësish të shkojë për plotësimin e nevojave të administratës gjyqësore.

Konkretisht nevojat për punonjës të administratës gjyqësore janë përcaktuar në vijimësi nga nevojat e paraqitura nga gjykatat, nga analizat e bëra nga specialistë të ish-Zyrës së ZABGJ-së, duke vendosur disa kritere të nevojave dhe me tendencën për t'i vendosur gjykatat në të njëjtin nivel të plotësimit të nevojave të tyre, kjo kryesisht për sekretaret gjyqësore, kryesekretaret, e pozicione të tjera.

Nga analiza e detajuar e bërë për përcaktimin e nevojave të administratës, pas hyrjes në fuqi të daljes së ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor, rezulton se numri i punonjësve duhet të rritet përafërsisht me 321 punonjës, me qëllim që të shkohet në plotësimin e nevojave të gjykatës për rritjen e efijencës në gjykimin e çështjeve, rritjen e solemnitetit, dhe në fund për arritjen e qëllimit kryesor, rritjen e besimit të publikut tek drejtësia.

Atëherë, po të shohim relacionin, ajo që kemi propozuar ne lidhur me shpërndarjen e 20 punonjësve, referuar tabelës, kemi bërë një shpërndarje në 16 gjykata,

ku konkretisht është propozuar që, për Gjykatën e Apelit Durrës të kalojë 1 punonjës për magazinier/arkëtar. Tek Gjykata e Apelit Shkodër të kalojnë 2 punonjës, 1 sekretar, 1... Për Gjykatën e Apelit Tiranë, prapë kemi 1 punonjës. Për Gjykatën e Apelit Vlorë, prapë 1 punonjës. Për gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, propozohen 2 punonjës. Për Gjykatën e Rrethit Durrës, 1 punonjës. Për Gjykatën e Rrethit Fier, 1 punonjës. Rrethi Gjirokastrë, 1 punonjës. Për Gjykatën e Rrethit Krujë, 1 punonjës. Për Gjykatën e Rrethit Kurbin, 1 punonjës. Për Gjykatën e Rrethit Lezhë, 1 punonjës. Për Gjykatën e Rrethit Tiranë, 1 punonjës. Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Durrës, 2 punonjës. Për Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, 1 punonjës dhe për Gjykatën Administrative Shkalla e Parë Vlorë, 2 punonjës, si dhe për Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, 1 punonjës.

Ky është propozimi që ka bërë Komisioni, pasi mori në konsideratë vlerësimet e bëra nga stafi i Menaxhimit të Buxhetit për këtë çështje.

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, tek varianti i propozuar, që sipas relacionit është varianti 2, ka një lapsus tek kolona "Totali". Gjykata e Apelit Shkodër ka në fakt 2 punonjës në total, kurse Gjykata e Apelit Tiranë, sipas të dhënave, ka 1. Është bërë lapsusi tek kolona e fundit.

Naureda Llagami: Ja, ta kontrollojmë.

Ilir Toska: Apeli Shkodër, që është numri 2 i renditur, ka 2 punonjës. Apeli Tiranë ka 1. Tek kolona e fundit është ndërruar vendi. Ka lapsus.

Naureda Llagami: Faleminderit!

(Ka një moment pauzë për të verifikuar tabelën e sipërcituar.)

Duke marrë parasysh sugjerimin e bërë nga zoti Toska, po e rilexoj edhe një herë shpërndarjen e punonjësve.

Atëherë për Gjykatën e Apelit Durrës, 1;

Për Gjykatën e Apelit Shkodër, 2;

Për Gjykatën e Apelit Tiranë, 1;

Për Gjykatën e Apelit Vlorë, 1;

Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, 2;

Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, 1;
Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, 1;
Për Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë, 1;
Për Gjykatën e Rrethit Krujë, 1;
Për Gjykatën e Rrethit Kurbin, 1;
Për Gjykatën e Rrethit Lezhë, 1;
Për Gjykatën e Rrethit Tiranë, 1;
Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, 2;
Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 1;
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, 2, dhe;
Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, 1.

Në total 20.

Atëherë, e kalojmë, sipas korigjimeve të bëra, projekt-aktin në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të miratojë, detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata, të akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2019, sipas propozimit të bërë nga Komisioni dhe korigjimeve të bëra nga anëtarët.

Ndonjë çështje tjetër, mund të kemi për diskutim?

Jo!

Faleminderit për prezencën!

Mbledhja është e mbyllur.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor